



Thirrje për aplikim

Tregu i Fundvitit 2023/24

“Tregu i Fundvitit” është aktivitet i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës (Kryeqyteti) për të festuar së bashku festat e fundvitit në hapësirë publike me muzikë, ushqim, pije dhe aktivitete argëtimi.

1) Vendi dhe orari i punës

Tregu i Fundvitit do të organizohet në sheshin “Xhorxh Bush” për 45 ditë kalendarike brenda periudhës 24 nëntor 2023 deri me 7 janar 2024. Ky treg do të organizohet nga biznese të cilat do të shfrytëzojnë shtëpizat e destinuara për këtë aktivitet dhe biznese mobile apo lëvizese, që nënkuptohen bizneset që do të vendosen në kamioneta apo mjete te ngjajshme.

Gjatë këtyre ditëve bizneset e përzgjedhura lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën, duke filluar prej orës 10:00 deri në orën 24:00. Përfundim janë datat 24 dhjetor, 31 dhjetor dhe 1 janar ku mund të punohet deri në orën 03:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Tregun e Fundvitit do të bëhet nga një komisioni i përcaktuar nga Komuna e Prishtinës.

Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e bizneseve të jetë sa më adekuate:

- 2.1 Bizneset do të aplikojnë për produkte ushqimore, laramani të pijeve të përshtatura me stinën e dimrit si dhe ide të ndryshme të realizueshme me motive dimërore;
- 2.2 Bizneset aplikuese duhet të jenë me adresë operimi në Komunën e Prishtinës;
- 2.3 Të paraqesin certifikatën e regjistrimit në ARBK (me informata të specifikuar në kategorinë e hotelarisë dhe gastronomisë);

- 2.4 Pika 2.2 nuk vlen për bizneset mobile apo lëvizëse, ato mund të mos e kenë adresën e operimit në Komunën e Prishtinës;
- 2.5 Bizneset aplikuese duhet të paraqesin menynë dhe ofertën me çmimore për artikujt që do t'i ofrojnë;
- 2.6 Nëse një person fizik është pronar i njëjtë apo bashkëpronar i dy apo më shumë bizneseve, mund të bëjnë vetëm një aplikim, d.m.th. mund të aplikoj vetëm një herë;
- 2.7 Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet një dokument identifikimi, (letërnjoftim, pasaport, patent shofer);
- 2.8 Gjatë aplikimit bizneset duhet të përcaktohen për cilën formë po aplikojnë; si biznese që do të shfrytëzojnë shtëpizat apo si biznese mobile/lëvizëse. Në rast aplikimi për të dytën, duhet të përshkruajnë mjetin që do t'a përdorin (për vendosjen e produkteve) dhe të njëjtin ta dëshmojnë me fotografi.

3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- 3.1 Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore;
- 3.2 Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative në fushën e kulinarisë dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së dimrit.

4) Tarifat e shfrytëzimit të shtëpizës:

- 4.1 Bizneset e përzgjedhura për shfrytëzimin e shtëpizave janë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej 1400 €, për shfrytëzimin e shtëpizës në hapësirën publike;
- 4.2 Bizneset mobile apo lëvizëse janë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej 1100 €, për shfrytëzimin e hapësirës publike;

5) Kodi i mirësjelljes dhe obligimet shtesë:

- 5.1 Të bëjë pagesën e tarifës dhe të njëjtën t`a paraqes në komunë, kur të ftohet për nënshkrimin e kontratës;
- 5.2 Të mos e bëjë shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërin prej shtëpizave;
- 5.3 Të mos shfrytëzojë hapësirën për kryerjen e veprave të jashtëligjshme;
- 5.4 Ndalohet rreptësishtë bartja e së drejtës së shfrytëzimit të hapësirës palëve të treta;
- 5.5 Muzika dhe performancat në hapësirat e këtij aktiviteti gjatë gjithë kësaj periudhe do të jetë e organizuar dhe e përbashkët. Muzika dhe performancat individuale të bizneseve në shtëpizat e tyre është e ndaluar rreptësishtë;
- 5.6 Obligohen të gjitha bizneset të sigurojnë hapësirën dhe mjetet e punës kundër dëmtimit/vjedhjes;
- 5.7 Të vendosin në vend të dukshëm çmimorën e produkteve;
- 5.8 Bizneset përfituese duhet të jenë të pajisura me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në këtë aktivitet;
- 5.9 Në shtëpiza nuk lejohet të futet aparati i kafes, përveç shërbimit me kafe instant.
- 5.10 Bizneseve të përzgjedhura do t`u lejohen vetëm 6 banake para shtëpizave tyre;
- 5.11 Të gjitha bizneset duhet të jenë në koordinim të plotë me kërkesat nga stafi i Komunës si dhe të respektojnë në përpikëri kontratën e nënshkruar.
- 5.12 Bizneset përfituese janë të obliguar të bashkëpunojnë me Komunën në dekorin e shtëpizave, pasi që të gjitha shtëpizat duhet të kenë pamje të njëjtë;
- 5.13 Të respektojnë orarin e përcaktuar të punës;
- 5.14 Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që të kenë shporta të mbeturinave afër shtëpizës së tyre, si dhe pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën dhe hapësirën rreth tyre;
- 5.15 Bizneset përfituese obligohen të kthejë shtëpizën/hapësirën në gjendjen e mëparshme me mbylljen e tregut dhe të merren përgjegjesitë për dëmet eventuale.

6) Mënyra e aplikimit

Afati për aplikim: Nga data 30.10.2023 deri më datën 9.11.2023 prej ores 09:00-15:00, Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), sporteli nr.1;

7) Procesi i ankesës

Me shpalljen e listës së bizneseve përfituese, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë tek Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave, Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), sporteli nr.1; në afatin e përcaktuar në listën e shpallur.

8) Vërejtje:

8.1. Komuna e Prishtinës nuk merr përsipër përgjegjësinë dhe obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës rreth arkës fiskale, andaj obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që kuponët fiskal t'i vërtetojnë (vulosin) në Administratën Tatimore të Kosovës.

8.2. Nëse nuk zbatohet kodi i mirësjelljes i sqaruar më lartë si dhe kontrata e nënshkruar, bizneset do të sanksionohen me marrjen e lejes për shtëpizë, do të futen në listën e zezë të Komunës së Prishtinës si dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzimin e saj.

8.3 Me shpalljen e listës , përfituesit do të njoftohen për kohën dhe vendin e nënshkrimit të kontratave dhe detajet tjera përcjellëse.